



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

20253  
Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 27.10.2020

**URDHËR**

Nr. 258, datë 27.10.2020

**PËR**

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PROGRAMIT TË TRAJNIMIT TË VIJUESHËM  
PROFESIONAL PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK PËR  
VITIN 2020 MIRATUAR ME URDHËR NR. 427, DATË 20.12.2019 TË MINISTRIT TË  
FINANCEVE DHE EKONOMISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 20 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikës 4, të nenit 8, si dhe germës f), të pikës 1, të nenit 12, të “Rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me urdhër nr.3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e ndryshimit të kalendarit të Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2020 miratuar me Urdhër nr. 427, datë 20.12.2019, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.



**MINISTËR**  
**Anila DENAJ**